



KUVENDI I KOMUNËS KOMITETI PËR POLITIKË DHE FINANCA

Procesverbal i mbajtur më 15 mars 2022, në mbledhjen e III-të (tretë)-e jashtëzakonshme mandati VII, të Komitetit për Politikë dhe Financa.

E thirrur në kërkesë të 17 këshilltarëve të Kuvendit të Komunës, nr.prot. 01-060/01-0018120/22 të datës 10 mars 2022, me pikën e rendit të ditës;

Mbledhja u mbajt në sallën nr.52, ndërtesa e re e Komunës, dhe filloi në orën 13:25.

Mbledhjen e hapi dhe kryesoi z.Hilmi Hoxha, Kryesues i Kuvendit, përkatësisht Kryesues i këtij Komiteti. Fillimisht u konstatua se në mbledhje ishin të pranishëm të gjithë anëtarët e këtij Komiteti: Naim Çunaku, Qëndrim Softolli, Arnisa Sylejmani, Adelinë Stublla, Florent Hasani, Sebastina Vokri, Bashkim Sylja dhe Mrika Thaçi.

Me këtë u konstatua se ekziston kuorumi për punë.

Në mbledhje i pranishëm ishte edhe; Fatlum Osmani, U.D. drejtor i Drejtorisë së Buxhetit dhe Financave-DBF, Driton Veliu U.D. drejtor i Drejtorisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale-DSHMS, Fatmir Rudari U.D. drejtor i Drejtorisë së Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural-DBPZHR.

Rendi i ditës

- **Ndarja e mjeteve buxhetore për pako ushqimore dhe higjienike për familjet me asistencë sociale dhe në nevojë.**

z.Hilmi Hoxha, Kryesues i Komitetit, e hapi mbledhjen duke i përshëndetur të pranishmit, theksoi, siç jeni të informuar paraprakisht në bazë të materialit në kërkesë të 17 këshilltarëve të Kuvendit të Komunës, nr.prot. 01-060/01-0018120/22 të datës 10 mars 2022, është thirr kjo mbledhje me pikën e rendit të ditës; Ndarja e mjeteve buxhetore për pako ushqimore dhe higjienike për familjet me asistencë sociale dhe në nevojë, lidhur me këtë pikë të rendit të ditës fjalën ia kaloi z. Qendrim Softolli.

z.Qendrim Softolli, theksoi, arsyeshmëria e thirrjes së kësaj mbledhje është cek edhe në material mirëpo do të ndërlihem në pika të shkurtra rreth arsyes së thirrjes së kësaj mbledhje e që është gjendja e rënduar ekonomike kohëve të fundit dhe rritja e vazhdueshme e çmimeve të artikujve esencial.

Duke e parë neglizhencën e nivelit qendror dhe atij lokal ne si grup i këshilltarëve të LDK-së e kemi parë të arsyeshme thirrjen e kësaj seance të jashtëzakonshme në mënyrë që sa do pak t'ju dalim në ndihmë këtyre familjeve. E dimë se një ndihmë e tillë nuk është e mjaftueshme duke parë gjendjen si shoqëri nëse mund të them se edhe këto familje sa do pak duhet ta ndjejnë dorën e shtetit. Sa i përket mundësive financiare prezent e kemi edhe drejtorin e Drejtorisë së Buxhetit dhe Financave, ne mendojmë se ka hapësirë, për arsyeshmëri mbetet të shihet, presim mbështetje edhe nga grupet e këshilltarëve të subjekteve tjera për arsye se kjo temë nuk mund të neglizhohet.

Fatlum Osmani, U.D. drejtor i Drejtorisë së Buxhetit dhe Financave-DBF, theksoi, e kam parë kërkesën e grupit të këshilltarëve të LDK-së dhe disa grupeve tjera për thirrjen e kësaj mbledhje, mirëpo pak është e rëndësishme se nga kush ka ardhë kjo thirrje e kësaj mbledhje sepse çështjet duhet të trajtohet nga të gjithë, në parim mbështetja për gupe të caktuara shoqërore në këtë rast sociale nuk mund

të kundërshtohet sepse nuk ekziston asnjë argument, mirëpo çështja është te propozimi i kësaj pike të rendit të ditës sepse kemi të bëjmë me disa limite buxhetore të cilat i përcaktojnë edhe qarkoret tjera buxhetore. Në këtë rast kjo mbështetje financiare për këtë kategori për të cilën është propozuar nga asamblistët e nderuar duhet të bëhet nga kategoria e subvencioneve. Komuna e Podujevës ka 960,000.00€ subvencione të cilat janë në qarkore buxhetore dhe janë të ndara në programe të caktuara. Në Drejtorinë e Arsimit Subvencione për bursa kemi 100,000.00€, në Drejtorinë e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale janë të ndara 100,000.00€, kryesisht këto mjete përdoren për ndihmë për rastet sociale për njerëzit që vuajnë nga sëmundjet kronike për blerjen e barërave, në Drejtorinë e Shërbimeve Publike Mbrojtjes dhe Shpëtim janë të ndara 90,000.00€, për mbulimin e shpenzimeve të ceremonisë së varrimit për personat e vdekur, subvencione këto që janë të ndara për Këshillin e Bashkësisë Islame në Podujevë. Në kategorinë e subvencioneve mjete tjera të ndara kemi në Drejtorinë e Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural dhe në Drejtorinë për Kulturë Rini dhe Sport që janë të ndara 50,500.00€, për teatër, këto mjete proceduralisht nuk mund t'i bartim sepse janë të përcaktuara në qarkoren buxhetore për financim specifik për teatër, ta përshkruaj me një fjalë këto janë mjete të ndara për subvencione.

Vitin e kaluar kanë qenë 760,000.00€, subvencione por ne kemi pasur kërkesa të vazhdueshme në Ministrinë e Financave që të rritet limiti i financave në kategorinë e subvencioneve sepse vazhdimisht kemi pasur probleme rreth adresimit të këtyre problemeve në kategorinë e subvencioneve.

Në parim çdo propozim që bëhet për ndarjen e mjeteve financiare nga kategoria e subvencioneve në çfarë do vlere, ajo vlerë duhet të merret nga këto kategori të subvencioneve, ne të gjithë këtu jemi për t'i mbështetur kategoritë sociale, në këtë rast nëse merr vendim asambleja komunale për ndarje të mjeteve financiare ta marrim shembull një shumë prej 50,000.00€, atëherë në atë vendim duhet të ceket se nga cila kategori mund të merren mjetet që nënkupton se mjetet financiare duhet të zvogëlohen për një kategori tjetër buxhetore. Tani shtrohet pyetja se a t'i zvogëlojmë bursat e studentëve, apo ta zvogëlojmë mbështetjen financiare për të sëmurët kronik, subvencionet në bujqësi, apo t'i zvogëlojmë mjetet financiare në shumë prej 50,000.00€ në Drejtorinë e Kulturës Rinisë dhe Sportit për klubet sportive që është mbështetje shumë e vogël ku të gjitha klubet sportive dhe aktivitetet rinore mbështeten me mjete financiare. Sa i përket subvencioneve në bujqësi ne pjesën dërmuese i kemi në procedurë të prokurimit ku formalisht mund t'i largojmë ato mjete por de fakto është e pa mundur se ato janë në procedurë të prokurimit, drejtorin e DBPZHR e kemi këtu mund të na jap sqarime mirëpo faktikisht kemi vetëm një projekt që s'ka kaluar në procedurën e prokurimit, nga propozuesi kërkoj që ta jap propozimin se ku të merren këto mjete në mënyrë që t'i mbështesim familjet me gjendje jo të mirë ekonomike.

z.Naim Çunaku, theksoi, të debatosh për një pikë të rendit të ditës ashtu siç e kemi propozuar në një seancë të jashtëzakonshme vërtetë kërkon maturi dhe kujdes arsyeje është se kemi të bëjmë me një kategori të rrezikuar sociale e cila jo me fajin e tyre është në atë gjendje. Ne si anëtarë të asamblesë komunale që na është besuar mandati nga ajo kategori dhe tani kemi një situatë të rënduar ekonomike dhe me ndarjen e këtyre mjeteve financiare nuk supozoj se do ta ngrisim gjendjen e tyre ekonomike dhe sociale në një nivel tjetër edhe pse kisha dashur shumë që edhe këtë kategori ta barazojmë me kategorinë tjetër shoqërore që janë në gjendje më të mirë ekonomiko-sociale, mirëpo nga ajo që dëgjova nga drejtori i DBF-së, kuptohet në një formë se ne si kuvendar duhet të hyjmë edhe në rolin e ekzekutivit dhe të hulumtojmë se nga cili projekt duhet t'i marrim mjetet financiare saktë në cilën kategori duhet t'i marrim mjetet në fjalë. Shuma prej 60,000.00€ mund të jetë në dis'harmoni nga ajo çfarë kemi projektuar mirëpo në bazë të njohurive që kam për subvencione Kuvendi Komunal nuk merr për herë të parë një vendim të tillë, hiç më larg se më datë 02.04.2020, Kuvendi ka marrë vendim për ndarjen e subvencioneve në shumë prej 125,000.00€. Sot nga ajo çfarë është duke ndodhur në tregun e Kosovës, falë Zotit këto dy ose tri ditët e fundit veç kemi një situatë më ndryshe nga ajo më parë sepse ditën e mërkure dhe të enjte të javës së kaluar e kemi parë atë invazionin, atë propagandën lufta, Mitrovica,

Rusia, Ukraina dhe është krijuar një gjendje shqetësuese te qytetarët që ndoshta kanë pas një gjendje jo të rrezikuar sociale e mos të flasim për kategoritë sociale. Nuk dua të marr kohë më shumë sepse në mbledhjen e kaluara të komitetit të gjithë jemi dakorduar që mos të hapim debate edhe pse KPF është komitet që duhet të përafroj mendimet dhe qëndrimet me grupe dhe t'i shqyrtojë se përndryshe sa për të dhënë një votë në Kuvend s'do të kishte nevojë që (KPF) të ekzistoj. Mendoj nëse ka sa do pak vullnet ekzekutivi dhe me mbështetje të Kuvendit Komunal kur ekzistojnë mundësitë buxhetore sepse jemi në fillim të vitit buxhetor mund të gjejmë atë shumë të mjeteve që do t'ju përgjigjet këtyre familjet me asistencë sociale dhe në nevojë, po e potencoj pa pretenduar se do ta ndryshojmë statusin e tyre të gjithë duhet ta kuptojnë se edhe këto familje duhet ta dëgjojnë një zë dhe një dorë dhe dikë që i she.

Fatlum Osmani, U.D. drejtor i Drejtorisë së Buxhetit dhe Financave-DBF, theksoi, ekzekutivi ka vullnet në këtë drejtim por ekzekutivi e ka paraqit një buxhet që është miratuar në asamblenë komunale, tani ka ardhë një propozim tjetër por faktikisht bëhet fjalë për ndryshim në buxhet prandaj kërkojmë nga propozuesi që ta paraqes propozimin konkret ku do të merren këto mjete financiare, subvencionet kanë natyrë sociale, shembull bursa ka natyrë sociale sepse bëhet fjalë për një bursë të vogël, gjithashtu edhe subvencionet në shëndetësi dhe në shërbime publike kanë natyrë sociale. Tani fatkeqësisht edhe subvencionet në fushën e sportit dhe të kulturës i kemi të natyrës sociale se janë subvencione të vogla, tani ne jemi duke prekur në çështje sociale për të rregulluar disa çështje sociale në parim ky propozim është në rregull por nga ana e propozuesit duhet të precizohet se ku duhet të merren mjetet.

Ne si ekzekutiv kemi një buxhet dhe për këtë ndryshim nga thirrësi i seancës duhet të bëhet propozimi konkret se në cilën kategori të subvencioneve duhet të merren mjetet financiare, sa i përket temës që potencoj z.Qendrim Softolli për nivelin qendror dhe lokal se nuk janë duke marrë parasysh çështjet sociale ju rikujtoj se rreth dy muaj më parë në Kuvendin e Republikës së Kosovës ka ardhë një propozim për marrjen e një kredie në shumë rreth 60,000,000.000€, nga këto mjete një shumë e caktuar ka qenë e destinuar për çështjet sociale për reformimin e sistemit social. Është rasti i parë që për një marrëveshje për financim që ka qenë një pjesë grant e një pjesë kredi nuk ka kaluar në Kuvendin e Republikës së Kosovës edhe pse LVV ka shumicën e votave në Kuvend sepse janë dashur 2/3 e votave të deputetëve të Kuvendit të Republikës së Kosovës, kjo marrëveshje nuk ka kaluar dhe është refuzuar nga ideja e LDK-së, me arsyetimin se ne jemi parti e djathtë dhe nuk merrem me çështje sociale, tani këtu është një kontraditë e thellë por prapë se prapë vullnet kemi për t'i mbështetur këto kategori por vetëm kërkojmë nga propozuesi që të cek se nga cila kategori e subvencioneve do të merren mjetet financiare, buxheti është dokument publik vetëm tregona se nga cila kategori e subvencioneve të merren mjetet.

z.Qendrim Softolli, theksoi, s'kam dëgjuar ndonjëherë se merret kredi për t'i trajtuar çështjet sociale.

Fatlum Osmani, U.D. drejtor i Drejtorisë së Buxhetit dhe Financave-DBF, theksoi, merret kredi atëherë kur s'ke.

z.Qendrim Softolli, theksoi, vetëm pak po krenoheni duke thënë kemi miratuar buxhetin më të madh deri më tani.

Fatlum Osmani, U.D. drejtor i Drejtorisë së Buxhetit dhe Financave-DBF, theksoi, keni thënë se jeni parti e djathtë nuk merremi me çështje sociale këtë e ka thënë deputeti Arben Gashi.

z.Qendrim Softolli, theksoi, po ndërlihem me atë se është miratuar buxheti më i madh deri më tani dhe po kërkojmë kredi për me i trajtuar rastet sociale kjo është totalisht e pa logjikshme, cilin projekt e sheh ti më të rëndësishëm se kategoritë sociale, unë mendoj se këto kategori janë primare, propozuesi ju thotë se te kategoria e subvencioneve keni të ndara 960,000.00€, kërkesa e jona është prej tyre të ndahen vetëm 60,000.00€, çka, qysh e arsyeton ky Kuvend që e ka miratuar këtë buxhet dhe ky Kuvend i jep dritë të gjelbër për tu ndryshuar kjo pikë që ne e shohim më të arsyeshme që ai fond të ndahet për skemën sociale se për kategoritë tjera të cilat si i prekni e keni në dorë ju se ju jeni ekzekutivi jo unë.

Unë bëra propozimin nëse Kuvendi vendos të bëjë ndarjen e mjeteve atëherë detyrë e juaja është t'i gjeni mjetet pasi që propozimi ka kaluar përmes këtij Kuvendi.

z.Naim Çunaku, theksoi, lidhur me diskutimin rreth këtij propozimi jam munduar që të jem i kujdesshëm dhe hiç nuk kisha pas qejf të merrem me ndarjen e subjekteve qoftë të majta apo të djathta se si qëndrojmë dhe si janë të ndara subjektet në Kosovë nga ana deklarative dhe nga ana vepruese e tyre LDK ka orientim si subjekt i djathtë dhe na bënë krenar që jemi subjekt i djathtë dhe mendojmë djathtë dhe në shtëpi hyjmë në anën e djathtë.

znj.Adelina Stublla, theksoi, varet se a jeni për ngut.

z.Naim Çunaku, theksoi, dikush mund të marrë në thua, por ne fjalën e kishin në aspektin institucional. Në fillim të fjalisë time e thash se për këtë propozim pavarësisht germave dhe numrave dhe subjekteve politike sepse për mua është një (orientim) e majtë të subvencionosh bizneset private si për energji elektrike për oligarkët e që është krejt e kundërt me atë se çfarë është deklaruar, mirëpo nuk dua të kyçem në atë temë për të bërë politika të nivelit qendror sepse jemi këtu për të paraqitur një problem social që e ka atakuar një shoqëri të caktuar sociale dhe a mund të bëjmë zgjidhje sa do pak për ta nëse ka vullnet e bëjmë një zgjidhje, nëse nuk ka vendimi merret me shumicë të votave dhe jemi në rregull.

Fatlum Osmani, U.D. drejtor i Drejtorisë së Buxhetit dhe Financave-DBF, theksoi, në këtë rast vetëm çështjen e vullnetit nuk duhet ta cekim por tani mos të futemi rreth diskutimeve për ndarje të subjekteve të majta dhe të djathta se ne e kemi përnjëmend orientimin e majtë politik ashtu siç e mendojmë kurse subjektet tjera e kanë orientimin e përzier por ajo është çështje tjetër, madje kam përshtypje se nuk kanë fare orientim politik.

z.Naim Çunaku, theksoi, drejtor kisha pas dëshirë të na shpjegoni këtu se çfarë është orientimi i majtë dhe i djathtë politik dhe çka kupton me orientim të majtë apo të djathtë politik.

Fatlum Osmani, U.D. drejtor i Drejtorisë së Buxhetit dhe Financave-DBF, theksoi, e rëndë është kjo temë shkollat e mendimit ekonomik diqysh janë pak të rënda.

z.Naim Çunaku, theksoi, dihet ajo një gjenezë se ku buron dhe si u rreshtuan qytetarët në të djathtë dhe të majtë.

Fatlum Osmani, U.D. drejtor i Drejtorisë së Buxhetit dhe Financave-DBF, theksoi, në Bota Sot është ajo por tjetër gjenezë ka krejt por jashtë këtij debati thotë thjeshtë këto janë fonde dhe ka menduar ekzekutivi jemi për dhe nuk e anashkalojmë këtë çështje ne po kërkojmë nga ju që na keni thirr në këtë mbledhje se nga cila kategori mendoni t'i merrni këto mjete dhe çka konsideroni më pak prioritet jepni propozimin dhe në fund do ta realizojmë.

z.Hilmi Hoxha, Kryesues i Komitetit, theksoi, ju lutem vetëm mos të kalojmë në një debat jashtë temës së thirrur.

z.Naim Çunaku, theksoi, insistimi i drejtorit të DBF-së, që propozuesi në këtë rast të përcaktoj saktë se nga cila vijë buxhetore cili subvencion të zvogëlohet dhe të orientohet për propozimin e Grupit të Këshilltarëve të LDK-së, të mbështetur edhe nga Grupet e Këshilltarëve të partive tjera po më duket se Qendrimi nuk e potencoj vijën buxhetore.

Fatlum Osmani, U.D. drejtor i Drejtorisë së Buxhetit dhe Financave-DBF, theksoi, tani ju tregoj se çka shpërfaq kjo mungesë e dëshirës suaj për të dhënë propozimin.

z.Naim Çunaku, theksoi, i nderuari drejtor nëse Kuvendi Komunal i Podujevës e sheh se projekt buxheti i miratuar nuk është i arsyeshëm e ka mundësinë ta refuzoj mirëpo të hyhet dhe mos të gjinden 60,000.00€, për këtë kategori dhe të bëhet ajo loja tregoma vijën buxhetore se ku t'i marrë mjetet financiare, këtë do ta bëni ju drejtor jo ne.

Fatlum Osmani, U.D. drejtor i Drejtorisë së Buxhetit dhe Financave-DBF, theksoi, mos te politizojmë këtë çështje sociale, absolutisht nuk dëshirojmë të partizojmë se politikë është kjo farë pune por s'ka rëndësi por jemi në rregull sepse ekziston vullneti për ndarjen e këtyre 60,000.00€, por nuk mund të vish

këtu dhe të thuash se me propozim të propozuesit tonë u ndanë 60,000.00€, për kategorinë sociale ndërsa LVV i zvogëloi subvencionet, do të thotë propozuesi që ka bërë propozimin për ndarjen e këtyre subvencioneve ai duhet të na tregoj në parim se në cilën kategori subvencionet duhet të zvogëlohen mjetet se pastaj thotë se LVV i zvogëloj subvencionet për barëra e ne i rritëm subvencionet për furnizim me ushqim, nuk mund të na e shitni këtë çështje.

z.Qendrim Softolli, theksoi, arsyeshmërinë e gjeni ju drejtor sepse ju jeni i emëruar për kryerjen e asaj pune, unë si anëtar i Kuvendit e jap propozimin, pse e ndërlihdni temën me listën esenciale të barërave prej 960,000.00€ në kategorinë e subvencioneve jemi duke diskutuar vetëm për 60,000.00€.

Fatlum Osmani, U.D. drejtor i Drejtorisë së Buxhetit dhe Financave-DBF, theksoi, unë kam një propozim të datës 02 prill 2020, pastaj ky propozim është bërë vendim dhe në bazë të këtij vendimi janë ndarë 125,000.00€, janë zvogëluar 80,000.00€ subvencione në Drejtorinë e Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, 20,000.00€, në Drejtorinë e Kulturës Rinisë dhe Sportit, 15,000.00€ në Drejtorinë e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale, 10,000.000€ në Drejtorinë e Shërbimeve Publike Mbrojtje dhe Shpëtim, por tani në propozimin tuaj ju duhet të tregoni se nga cila kategori duhen të merren këto 60,000.00€, ju po thoni se këtë konsideroni prioritet, çka konsideroni më pak prioritet.

z.Qendrim Softolli, theksoi, unë ty ta bëra pyetjen se çka sheh me më pak prioritet se kjo vepra.

Fatlum Osmani, U.D. drejtor i Drejtorisë së Buxhetit dhe Financave-DBF, theksoi, ju duhet ta jepni propozimin.

z.Qendrim Softolli, theksoi, ti e ke bërë kategorizimin e subvencioneve apo tani e ke edhe një mundësi vjen subvencionimi i skemave sociale atëherë ti e bënë kategorizimin se cila kategori të jetë më pak e rëndësishme se ky propozim që e kemi propozuar ne.

Fatlum Osmani, U.D. drejtor i Drejtorisë së Buxhetit dhe Financave-DBF, theksoi, këtë mundësi e keni propozuar ju në rregull, propozimin dërgojeni deri në fund kjo është kërkesa.

z.Qendrim Softolli, theksoi, deri në fund propozimin do ta dërgojmë.

Fatlum Osmani, U.D. drejtor i Drejtorisë së Buxhetit dhe Financave-DBF, theksoi, dërgojeni propozimin deri në fund se nga cila kategori duhet të merren këto mjete.

z.Bashkim Sylja, theksoi, nëse ne anëtarët e KPF-së nuk marrim vendim është problem të merret një vendim nga të gjithë anëtarët e Kuvendit në mbledhjen e radhës.

z.Driton Veliu, U.D drejtor i Drejtorisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale-DSHMS, theksoi, sa i përket subvencioneve në shëndetësi ne e kemi trashëguar një shumë prej 70,000.00€, këtë shumë e kemi rrit për vitin fiskal për 30,000.00€, që në total i bie 100,000.00€, gjatë vitit të kaluar kemi vëzhguar, investiguar kategoritë të cilat janë shumë të ndjeshme. Shumë qytetarë janë kapluar nga sëmundjet serioze ku karcinomat janë rritë shumë dhe si pasoj e tyre kemi rritje të kërkesave të qytetarëve të këtyre kategorive andaj ne si rezultat i saj e kemi rrit shumën e subvencioneve prej 50,000.00€, në 80,000.00€, për kategoritë që kanë sëmundje serioze siç janë karcionomat, tumoret e ndryshme, shërimi jashtë vendit, fibrozat cistike dhe për sëmundjet e rralla qofshin të lindura apo të trashëguara për të cilat duhet trajtim ditor dhe kanë kosto të lartë, andaj këtë kategori të subvencioneve e kemi rritë për 42%. Imagjinoni vetëm në muajin janar komisioni ka pranuar kërkesat për subvencionim të barërave në shumë prej 18,000.00€, shto këtu edhe kërkesat e muajve të tjerë që kanë marrë mbështetje të vazhdueshme ku shumica e tyre kanë sëmundje të rënda si tumore, karcinoma të ndryshme ku familjarët e tyre kanë harxhime të mëdha ditore për trajtimin e këtyre sëmundjeve. Nga kjo shumë prej 80,000.00€ ne kemi nda 20,000.00€ për OJQ-të që ofrojnë shërbime për qytetarët me nevoja të veçanta, këtu bëjnë pjesë 12,000.00€, për OJQ Hendikos që është organizata me numrin më të madh të anëtarëve që janë rreth 750 anëtar, këtë vit shpresojmë që t'ia ndajmë rreth 12,000.00€, pastaj kemi edhe një kategori tjetër të rëndë që janë familjet që kanë fëmijë me autizëm, autizmi është një çrregullim psikik i cili duhet të trajtohet në kohë të duhur, seancat e tyre janë shumë të shtrenjta e që shumica e tyre kryhen në

ordinanca private, në shkollën “Dr. Ibrahim Rugova” është një qendër e autizmit afërsisht janë 20 fëmijë të lajmëruar, mundësit janë që të ketë edhe fëmijë të tjerë sepse një numër të madh të fëmijëve familjarët e tyre i dërgojnë në qendrën e autizmit në Prishtinë. Ne jemi të interesuar që këtyre familjeve t’ju ofrojmë një subvencionim për mbulimin e shpenzimeve javore dhe mujore që i kanë për trajtimin e këtyre fëmijëve me autizëm, ne e kemi llogaritur një shumë prej 10,000.00€ për nevojat e tyre, mirëpo ne kemi edhe OJQ tjera siç është ajo e shurdhmemecëve, verbërve e shumë të tjera të cilat kanë kërkesa ditore, kjo shumë prej 100,000.00€ përbën rritjen prej 42% të subvencioneve.

Ne kemi 957 familje me asistencë sociale të cilat jetojnë në kushte të rënda ekonomike, shto këtu edhe rritjen e çmimeve të artikujve bazë kurse asistencë sociale ka mbetur e njëjta, por nëse ne ju ndajmë nga një pako në shumë prej 50 € i bie një vlerë rreth 50,000.00€, dhe nëse i marrim këto mjete financiare nga kategoria e subvencioneve i bie që këto mjete do të merren nga kategoria e subvencioneve për sëmundje të rënda. Sa i përket neglizhimit të institucioneve lokale nuk është e vërtetë kjo, në kohën tonë vitin e kaluar ne kemi marrë subvencione rekorde prej organizatave prej kohës që kur ekziston DSHMS, duke përfshirë edhe kohën e komunizmit i kemi marrë mbi 400,000.00€ subvencione, mbi 4000 pako ushqimore dhe lëndë djegëse shto këtu edhe shërbimet shëndetësore.

z.Qendrim Softolli, theksoi, sa i përket trajtimeve shëndetësore shumica janë në lista esenciale që merren në onkologji nuk është ndonjë trajtim që ofrohet prej nivelit lokal.

z.Driton Veliu, U.D drejtor i Drejtorisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale-DSHMS, theksoi, mbi 400,000.00€ i kemi marrë subvencione pako dhe lloj lloj ndihmash dhe jemi duke vazhduar dhe kjo nuk është bërë si shkak i neglizhencës por për shkak të bashkëpunimit të ngushtë me donator të ndryshëm bashkëpunim i cili po vazhdon dhe pritjet që gjatë muajit të ramazanit do të rritet numri i pakove ushqimore. Ju e keni bërë propozimin ne e përkrahim jemi në rregull, a kanë nevojë familjet me asistencë sociale për pako ushqimore unë them po sepse unë çdo ditë përballem me kërkesat e tyre, ku me i marrë mjetet financiare, a me i heqë këto mjete nga kategoria e subvencioneve për sëmundjet e rënda për pacientët që vuajnë nga kanceri.

z.Naim Çunaku, theksoi, drejtor në rend të parë të përgëzoj për aktivitetin që e pasqyrove këtu që me punën e juaj keni arrit me marrë donacione që s’ka mundur asnjë pushtet më shumë madje e përmende edhe kohën e komunizmit që atë periudhë nuk e dimë por le të jetë si të jetë. Dëgjova me vëmendje dhe e them të drejtën kur i numërova ato kategori që kanë nevojë për mbështetje s’kam se si mos të ndihem keq nëse nuk mundemi ne me i mbështet por nëse thirrmi në shkurtimin e saj që e kemi propozuar ne me vetë faktin që nga dy drejtorët insistohet se ne duhet t’ju tregojmë se nga cila kategori të merren këto mjete financiare po del në diçka politike dhe ashtu siç thoni ju tregoni se nga cila kategori të merren këto mjete financiare, ne themi se kjo është përgjegjësi e juaja kurse përgjegjësi e jona është me vendos sepse i kemi punët e ndara. Drejtor po të jap një premtim këtu se sigurisht do të kemi bartje të të hyrave vetanake qoftë edhe rishikim të buxhetit, këto kategori që sot i numërova kanë nevojë për ndihmë, sot premtoj që do ta kenë mbështetjen time të ndajmë mjete financiare varësisht nevojave që ju i paraqitni, po e them publikisht sot po e premtoj edhe do ta japë atë mbështetje.

z.Driton Veliu, U.D drejtor i Drejtorisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale-DSHMS, theksoi, e keni pasur mundësinë herën e kaluar të votoni për propozim vendimin për ndarjen e drurëve për familjet në nevojë por se keni votuar.

z.Naim Çunaku, theksoi, ju lutem mos na ktheni në mbledhjen e datës 25 shkurt 2022.

z.Driton Veliu, U.D drejtor i Drejtorisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale-DSHMS, theksoi, nuk e keni votuar atë propozim dhe nuk e di a ka ndonjë parti opozitare në ndonjë komunë që nuk e voton propozim vendimin për ndarjen e drurëve për familjet në nevojë duke e ditë se ato dru ne do t’ia shpërndajmë këtyre familjeve.

z.Naim Çunaku, theksoi, ju lutem mos na ktheni në mbledhjen e datës 25 shkurt 2022 dhe mbledhjen e datës 28 shkurt 2022, sepse ai propozim ka ardhë nga drejtori i DBPZHR i cili është prezent këtu, të cilit ju kam drejtuar të lutem shqyrtoje bazën ligjore a jemi në rregull me ligjin, nëse jemi në rregull me ligjin ne jemi për. Forma qysh ka ndodhur në mbledhjet e datës 25 dhe 28 shkurt 2022, shpresoj të harrohen por frikësohem se nuk do të harrohen deri në fund të mandatit. Arsyen pse do e debatojmë kur e kemi një mbledhje të rregullt, jo që e kemi tejkaluar atë se nuk e kemi tejkaluar dhe ne kemi disa vërejtje se janë disa shkelje dhe do ta kthejmë prapë si temë të debatit në kuvend por sot nuk kisha dashur të kyçem në atë temë sepse në fillim të kësaj mbledhje i thash kryesuesit se po të ishte një mbledhje tjetër unë nuk do të isha pjesëmarrës në këtë komitet por është një temë e ndjeshme dhe duhet të jemi këtu.

Pa të keqe duhet ta kuptoni që jeni në pozitë, duhet ta kuptoni fundja se edhe propozimet e opozitës ju qesin nganjëherë në telashe duhet ta kuptoni është e natyrshme kjo vendimi është i joni zgjidhja është e juaja këtu jemi.

z.Hilmi Hoxha, Kryesues i Komitetit, theksoi, sa shohë unë vullneti ekziston.

z.Qendrim Softolli, theksoi, vullnet ka pas edhe herën e kaluar janë nda dhe arsyetuar 125,000.00€, këtë e ka bërë ekzekutivi.

Fatlum Osmani, U.D. drejtor i Drejtorisë së Buxhetit dhe Financave-DBF, theksoi, nuk është çështja arsyeshmëria, çështja është vendimi nga cila kategori e subvencioneve të merren mjetet financiare.

z.Qendrim Softolli, theksoi, po i thoni vendim por më shumë është arsyeshmëri, nuk e di pse po e politizoni këtë çështje.

Fatlum Osmani, U.D. drejtor i Drejtorisë së Buxhetit dhe Financave-DBF, theksoi, nuk është kjo çështje politike.

z.Qendrim Softolli, theksoi, shihet se është çështje puro politike.

Fatlum Osmani, U.D. drejtor i Drejtorisë së Buxhetit dhe Financave-DBF, theksoi, këtu kam vendimin e vitit 2020, në bazë të neni 1, janë ndarë 120,000.00€, subvencione për shkak të pandemisë covid-19. Mjetet financiare që ndahen me vendim ne dhe Naimi dhe ju të tjerët që keni përvojë të gjatë në asamblenë komunale dhe disa në ekzekutiv e dimë se çdo vendim duhet të shkoj në ministri për vlerësim të ligjshmërisë që do të thotë në rast se brenda vendimit të cilin duhet ta marrë asambleja komunale nuk ceket se nga ku të merren këto mjete buxhetore ky vendim është nul.

z.Qendrim Softolli, theksoi, ne jemi duke e cekur në kategorinë e subvencioneve.

Fatlum Osmani, U.D. drejtor i Drejtorisë së Buxhetit dhe Financave-DBF, theksoi, jo vetëm në kategorinë e subvencioneve, nga ku se aty ka programe.

z.Qendrim Softolli, theksoi, kategoria e subvencioneve ne saktë po e cekim se ku të merren mjetet financiare.

Fatlum Osmani, U.D. drejtor i Drejtorisë së Buxhetit dhe Financave-DBF, theksoi, nuk jeni duke e cekur saktë propozimin.

z.Qendrim Softolli, theksoi, nëse kthehet nga ministria vendimi si i jashtëligjshëm ajo është çështje tjetër, nuk është përgjegjësi e imja ajo.

Fatlum Osmani, U.D. drejtor i Drejtorisë së Buxhetit dhe Financave-DBF, theksoi, vendimin e voton kuvendi qysh nuk është përgjegjësi e juaja, ti nuk mund të marrësh vendime jo ligjore, mundesh por pastaj nuk mundesh. Mjetet financiare në shumë prej 125,000.00€, duhet me i cekë se ku duhet të merren.

z.Naim Çunaku, theksoi, krejt dhe drejt Kosova për të gjithë drejtor dhe Podujeva për të gjithë për të gjitha kategoritë.

Fatlum Osmani, U.D. drejtor i Drejtorisë së Buxhetit dhe Financave-DBF, theksoi, propozuesi në këtë rast nuk është ekzekutivi, ka një subjekt ose një grup i asamblistëve që nga ta ka ardhë një propozim, ai propozim duhet të kthehet në vendim, propozimi duhet të kalojë dhe pastaj vendos asambleja.

z.Naim Çunaku, theksoi, atëherë le të vendos asambleja.

Fatlum Osmani, U.D. drejtor i Drejtorisë së Buxhetit dhe Financave-DBF, theksoi, në rregull vetëm specifikojeni propozim vendimin.

z.Naim Çunaku, theksoi, këtë po ua lëmë juve po ju nderojmë këtë herë.

z.Driton Veliu, U.D drejtor i Drejtorisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale-DSHMS, theksoi, unë jam i sigurt se në DSHMS, nuk do të merrni mjete financiare.

z.Naim Çunaku, theksoi, ju dhashë një premtim publik për arsyetimin që e dhatë për kategoritë në nevojë sa do që të jetë ajo kosto prej të hyrave vetanake në bartje do t'i mbështes.

z.Hilmi Hoxha, Kryesues i Komitetit, theksoi, është mirë që këtë propozim vendim në këtë mbledhje ta specifikojmë pastaj të kaloj në kuvend.

z.Naim Çunaku, theksoi, e kemi nderin dhe kënaqësinë të na propozoni propozimin ne e mbështesim ose e refuzojmë zgjidhjen gjejeni ju jo ne.

Fatlum Osmani, U.D. drejtor i Drejtorisë së Buxhetit dhe Financave-DBF, theksoi, çka nëse ju i kishit propozuar 900,000.00€, a e dini se kjo i bie që asnjë subvencion tjetër të mos ekzistoj.

z.Naim Çunaku, theksoi, drejtor a kemi ne fond rezervë në buxhet.

Fatlum Osmani, U.D. drejtor i Drejtorisë së Buxhetit dhe Financave-DBF, theksoi, jo nuk kemi ne fond rezervë në buxhet.

z.Naim Çunaku, theksoi, a është e mundur të kemi fond rezervë.

Fatlum Osmani, U.D. drejtor i Drejtorisë së Buxhetit dhe Financave-DBF, theksoi, niveli lokal nuk pareshe fonde rezervë, fondet rezervë janë për ata që nuk din të bëjnë buxhet, por këtë herë ka pasë kush e bënë buxhetin.

z.Naim Çunaku, theksoi, s'duhet me thënë nesër në Kuvend por po e them këtu prej kureshtjes se prej se ka filluar punën kjo asamble ky mandat i VII-të, i kuvendarëve a e dini ku e kemi një karakteristikë që po na përcjellë kemi 3 mbledhje solemne, 3 mbledhje të jashtëzakonshme dhe 3 mbledhje të rregullta dhe me bë me na shpjegu dikush me gjuhën e statistikës që më tepër janë veçori e financave atëherë na del që jemi edhe të rregullt edhe të jashtëzakonshëm dhe solemn.

z.Hilmi Hoxha, Kryesues i Komitetit, theksoi, mbledhjet solemne ne nuk mund t'i kalojmë.

z.Naim Çunaku, theksoi, nuk mund të kalohen por vetëm po tregoj se ku jemi.

z.Hilmi Hoxha, Kryesues i Komitetit, theksoi, drejtor a ka mundësi që ne t'i marrim mjetet nga ndonjëra prej kategorive të subvencioneve prej cilit do program por kur të vjen koha e ridestimitit në qoftë se na teprojnë mjete, ato mjete me i ridestinu prapë në atë program.

Fatlum Osmani, U.D. drejtor i Drejtorisë së Buxhetit dhe Financave-DBF, theksoi, janë limitet në qarkoret buxhetore dhe varet se sa i ke paga, investime kapitale, mallra dhe shërbime, subvencione, komunali që t'i përcakton edhe ligjërish nuk guxon asnjë euro me kaluar atë sepse atë vendim ministria e kthen në raport me ligjin për buxhet, ligjin për ndarjen buxhetore, qarkoret buxhetore që janë derivat i këtyre dy ligjeve në qoftë se ne i tejkalojmë këto limite. Për këtë vit limitin e subvencioneve e kemi 960,000.00€, mjetet janë nda në këto kategori po e them në mënyrë specifike shembull këtu kemi një renditje 50,050.00€ në teatër, këto mjete nuk mund t'i prekim sepse janë fond specifik për teatër.

z.Naim Çunaku, theksoi, mirëpo atëherë votojeni kundër.

Fatlum Osmani, U.D. drejtor i Drejtorisë së Buxhetit dhe Financave-DBF, theksoi, ne nuk votojmë kundër.

z.Qendrim Softolli, theksoi, votoni kundër këtij propozimi dhe arsyetohuni ashtu siç po na u arsyetoheni neve se po votoni kundër shumë e thjeshtë është kjo.

Fatlum Osmani, U.D. drejtor i Drejtorisë së Buxhetit dhe Financave-DBF, theksoi, ju duhet të arsyetoni se nga cila kategori e subvencioneve duhet të merren mjetet.

z.Qendrim Softolli, theksoi, e kemi thënë arsyetimin, arsyetim tjetër nuk kemi.

z.Bashkim Syla, theksoi, ideja është për të japë një propozim konkret, nëse unë e kisha bërë këtë propozim e kisha cek edhe kategorinë se ku do të merren mjetet financiare për mbështetje financiare të familjeve në nevojë, më mirë të dalim me një propozim në këtë takim se jemi asamblistë më pak të përfaqësuar nga të gjitha subjektet politike, prezent kemi edhe drejtorët e drejtorive përkatëse dhe bashkarisht besoj se kjo nuk na bënë mirë me marrë poena politikë. Lidhur me këtë çështje propozoj që të marrim 10 minuta pauzë, të diskutojmë se cilat janë kategoritë më pak të ndjeshme dhe të dalim me një propozim konkret. Unë nëse e kisha bërë këtë propozim e kisha cek edhe kategoritë dhe kodet buxhetore se ku do të merreshin mjetet financiare, propozimi ka ardhë prej LDK-së, tani nëse ju dëshironi të merrni lëvdata dhe të bëni politikë është gjë normale kjo punë, unë nuk e kontestoj, por nëse dëshironi cekeni edhe këtë pjesën tjetër se ju ndihmojmë edhe ne, le të marrim një pauzë prej 10 minutave dhe të shohim mundësit se prej cilave kategori prej cilit kod mund të merren këto mjete buxhetore.

z.Qendrim Softolli, theksoi, unë mund ta marrë e ta bëjë lëmsh buxhetin se nuk jam i thirrur për atë punë sepse janë drejtorët e emëruar që merren me këto punë.

z.Naim Çunaku, theksoi, ne kemi marrë një iniciativë kemi thirr një mbledhje për afërsisht kemi ardhë te pika ku nuk mund të gjejmë dakordim dhe krejt çka është e jona t'i rekomandojmë Kuvendit për shqyrtim ose me stopu.

z.Bashkim Syla, theksoi, unë mendoj se më mirë është t'i marrim 10 minuta pauzë dhe të gjejmë mundësinë se nga cila kategori buxhetore të ndahen mjetet financiare për familjet në nevojë.

znj.Adelina Stublla, theksoi, nuk kemi nevojë që të marrim pauzë sepse nuk jemi shumë anëtarë të KPF-së, andaj këtë çështje mund ta zgjedhim këtu.

z.Bashkim Syla, theksoi, unë mendoj se më mirë është ta zgjedhim sot këtë çështje dhe nuk kemi nevojë të bëjmë politikë sepse kemi të bëjmë me një kategori të rëndë ekonomike.

znj.Adelina Stublla, theksoi, ne grupi i LVV-së, këtë pikë të rendit të ditës ia rekomandojmë Kuvendit për shqyrtim, pastaj Kuvendi të vendos.

Fatum Osmani, U.D. drejtor i Drejtorisë së Buxhetit dhe Financave-DBF, theksoi, edhe nesër ai propozim që vjen duhet të jetë propozim i plotë, plotësimi është se duhet të bëhet një bilanc kur të ndahen mjetet buxhetore në këtë rast është një buxhet që e mban këtë limit po dëshironi me nda apo të shtoni mjete atëherë ato mjete duhet të merren dikund, propozimi duhet me ardhë i plotë nga propozuesi.

z.Qendrim Softolli, theksoi, propozimi të vije i plotë ashtu siç e parasheh drejtori apo ashtu siç e parasheh ligji.

Fatum Osmani, U.D. drejtor i Drejtorisë së Buxhetit dhe Financave-DBF, theksoi, kjo çështje është logjikë elementare.

z.Qendrim Softolli, theksoi, unë prej logjikës elementare po nisem dhe po propozoj.

Fatum Osmani, U.D. drejtor i Drejtorisë së Buxhetit dhe Financave-DBF, theksoi, në rregull të nisemi prej logjikes elementare por mos të del kjo shumë banale sikur t'i propozojmë 500,000.00€ me i nda për këtë çështje, do të thotë se e njëjta logjikë është.

z.Qendrim Softolli, theksoi, të njëjtën ti del dhe e arsyeton pse ashtu siç ti e ke arsyetuar buxhetin për me votu edhe kjo është njëfarë lloj arsyetimi po ose jo.

Fatum Osmani, U.D. drejtor i Drejtorisë së Buxhetit dhe Financave-DBF, theksoi, e marrim shembull t'i kemi 500,000.00€, dhe t'i dërgojmë në shëndetësi pak janë, tani është problemi se kush është kundër ndarjes së subvencioneve për shëndetësi, askush nuk është kundër.

z.Qendrim Softolli, theksoi, definitivisht nuk ia vlen i gjithë ky debat për këtë temë.

Fatum Osmani, U.D. drejtor i Drejtorisë së Buxhetit dhe Financave-DBF, theksoi, absolutisht vetëm ejani me propozim të plotë.

z.Qendrim Softolli, theksoi, propozimi është i plotë që e shihni ju gjysmak është tjetër temë, mirëpo këtë do e diskutojmë edhe në Kuvend, nëse e kthen Ministria si të pa ligjshëm është çështje tjetër barra bie mbi ne.

Fatlum Osmani, U.D. drejtor i Drejtorisë së Buxhetit dhe Financave-DBF, theksoi, do të thotë se propozimi i këshilltarëve të LDK-së, i mbështetur edhe na këshilltarët të subjekteve tjera që e kanë thirr këtë seancë e që besoj se këtë propozim duhet me mbështet të gjithë për ndarjen e 60,000.00€, për familjet në nevojë nga kategoria e subvencioneve për këto raste, propozimi fillon dhe mbaron këtu, në rregull po e them prapë se duhet specifikimi. Kur ka ardhë ish drejtori, ish ekzekutivi me këtë propozim para Kuvendit në vitin 2020, të cilin asambleja komunale e ka mbështetë, ky propozim ka ardhë me iniciativën e Kryetarit.

z.Qendrim Softolli, theksoi, këtu është diferenca mes Kryetarit dhe anëtarit të Kuvendit sepse ekzekutivin e përbëjnë Kryetari dhe drejtorët, ti me thirr këtë seancë e ke pasë mundësinë me bë kategorizimin.

Fatlum Osmani, U.D. drejtor i Drejtorisë së Buxhetit dhe Financave-DBF, theksoi, njësoi është.

z.Qendrim Softolli, theksoi, nuk është njësoj se unë nuk jam i thirrur për atë çështje.

Fatlum Osmani, U.D. drejtor i Drejtorisë së Buxhetit dhe Financave-DBF, theksoi, për çështje ligjore në këtë rast asamblisti është më i thirrur, ti vendos për buxhet, unë mund të bëjë propozime por ti vendos për buxhet, në këtë rast ti mundesh të japësh propozim dhe të vendosësh për buxhet, në këtë rast ke propozuar dhe duhet me vendos, unë mundem vetëm me të këqyr, ka drejtë Kryesuesi as fjalën mos me ma jap se nuk është propozim i imi.

z.Naim Çunaku, theksoi, ne jemi në një situatë këso fare që rolin e Kuvendit së pari duhet me ditë ne kuvendarët, roli i ekzekutivit është ndarazi nga kuvendarët, Kuvendi sjellë vendime dhe ka të drejtën e përfaqësimit, Kryetari bënë politika të cilat i ekzekuton ekzekutivi, nëse Kuvendi nesër e merr një vendim jo të ligjshëm e kemi Ministrinë e Pushtetit Lokal e cila e aprovon ose e kthen mbrapa do të thotë këtu jemi.

Fatlum Osmani, U.D. drejtor i Drejtorisë së Buxhetit dhe Financave-DBF, theksoi, më falni se po ndërhyjë prapë se këtu në këtë seancë mbetet se në parim mbështetet ky propozim dhe i rekomandohet Kuvendit për shqyrtim.

znj.Adelia Stublla, theksoi, këtë propozim e mbështesim dhe i rekomandojmë Kuvendit dhe nesër në Kuvend debatojmë meqenëse nuk bëmë zgjidhje këtu sa i përket specifikimit të propozimit.

z.Hilmi Hoxha, Kryesues i Komitetit, theksoi, në qoftë se nuk ka diskutime tjera atëherë këtë propozim e hedhim në votim që Kuvendit t'i rekomandohet për shqyrtim

Pas diskutimeve nga ana e anëtarëve të Komitetit për Politikë dhe Financa, përfaqësuesëve të Ekzekutivit të Komunës, dhe procesit të votimit, Kryesuesi i Komitetit konstatoi se njëzëri (me 9 vota për) i rekomandohet për shqyrtim Kuvendit të Komunës.

Kryesues i Komitetit e konstaton të përfunduar këtë mbledhje.

Mbledhja përfundoi në orën 14:10

Procesverbalin e mbajti

Osman Bajrami

Nr.01-060/04-0019294/22

Podujevë,

15 mars 2022

Kryesuesi i Kuvendit - Komitetit

Hilmi Hoxha